**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/**
**REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME**
**ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

Nr. i Protokollit: 02/569

# Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Vojnovc

E enjte, më 15 qershor 2023
Kohëzgjatja e takimit: 19:00 –20:10
Vendi i takimit: SHMFU ''Lasgush Poradeci''

Të pranishëm ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi; Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini; Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik - Kastriot Shabani dhe Drejtorja e Drejtorisë së Arsimit, Yllka Fejzullahu.

Rendi i ditës:

1. **Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026**

**z.Adnan Ademi-** Faleminderit te gjithëve per pjesëmarrjen tuaj ne këtë degjim publik.
Qellimi i këtij takimi eshte hartimi i buxhetit për vitet 2024-2026 dhe me ju do të bisedojmë për nevojat dhe kërkesat që keni secili prej jush në lagjet prej nga vini.
Kryesuesi e shpalli të hapur debatin: Këtu jam së bashku me drejtorin Grejtalb Emini, Drejtorin Kastriot Shabani, dhe me drejtoren Yllka Fejzullahu.
Presim nga ju kërkesa dhe propozime.

**Z. Grejtalb Emini (DPKUGJ)** – Në Vojnoc priten të bëhen disa investime kapitale të cilat perfshijnë rregullimin e trotuareve në disa lagje, rregullimin e ndriqimit, asfaltimin e rrugëve etj.
Ndoshta nevojat janë edhe më të mëdha por është përcaktuar një mesatare për çdo vendbanim.

**Z. Emini** i elaboroi në tërësi për të gjitha projektet urbane të realizuara deri më tani dhe projektet që priten të realizohen duke cekur edhe shumën e ndarë për secilën prej tyre.

**Z. Nexhmedin Mehmeti-** banor i këtij fshati theksoi se ka shumë nevojë për investim në fshat e me theks të veçantë në nevojën për ndërtimin e një shkolle të re pasi objekti në të cilin mbahet procesi mesimor tani nuk i përmbushë as nevojat elementare.
Problem tjetër në këtë shkollë është edhe trotuari, rregullimi i të cilit është nevojë urgjente.

**Z. Arif Shabani**- banor i këtij fshati theksoi se problem në këtë fshat është edhe moshapja e kanaleve kulluese të ujit, ku pas çdo reshje të shiut krijohen vërshime e që problem për këta banorë është edhe çështja e rrugëve të arave ku kërkoi edhe asfaltimin e këtyre rrugëve.

**Z. Ismet Rifati -** banor i këtij fshati theksoi se rregullimi i trotuarit ne skaj të Lumit është nevojë e madhe për banorët pasi ata frekuentojnë këtë rrugë çdo ditë.
Kerkese tjetër e këtij banori ishte edhe ndriqimi dhe asfaltimi i rrugës Kurti.

**Z. Kastriot Shabani (DZHE) -** Rregullimi i shtratit të lumit do të bëhet gjithashtu edhe lumi do të hapet deri te pjesa e Lipjanit.

**Z. Musa Shabani -** banor i këtij fshati e bëri të ditur se Vojnoci meriton përkrahje më të madhe pasi është njëri ndër vendet i cili merret më së shumti me bujqësi dhe për këtë arsye meriton edhe përkrahje me subvencionim.
Kërkesë tjetër e këtij banori është edhe kyçja në rrjetin elektrik të lapidarit i cili është ndërtuar nga vetë banorët e fshatit.

**Z. Besart Aliu** banorë i këtij fshati para të pranishmëve shprehu disa kërkesa:
Mbjellja e disa fidanëve dhe barit në rrugën Ibrahim Shabani.
Rregullimi i rrethojave të varrezave të cilat janë komplet të demoluara,
Asfaltimi, ndriqimi dhe rregullimi i trotuarit në lagjen Kurti.
Rregullimi i rrethojave të oborrit të shkollës. Ndarja e një shume të caktuar për mirëmbajtjen e fshatit.

**Z. Emini** i elaboroi në tërësi për të gjitha projektet urbane qe priten të realizohen duke cekur edhe shumen e ndarë për secilën prej tyre.

**Z. Gani Jashari** banor i këtij fshati kërkoi zgjerimin e rrugës Jashari gjithashtu edhe rregullimin dhe hapjen e kanaleve për grumbullimin e ujit.

**Z. Granit Ramadani** banorë i këtij fshati kërkoi riparimin e urës dhe ndriqimin përgjatë saj.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES • OPŠTINA ŠTIMLJE
SHTIME-ŠTIMLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Vendi: Vojnoc
Date: 15.06.2023

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Nenshkrimi |
|---|---|---|
| 1 | SHYQERI RIFATI | [signature] |
| 2 | NUSRET SHABANI | [signature] |
| 3 | Besart Aliu | [signature] |
| 4 | Drilon Shabani | [signature] |
| 5 | Adim Jashari | [signature] |
| 6 | Amir Shaqiri | [signature] |
| 7 | Ilaz Shaqiri | [signature] |
| 8 | MIRVAN MEHMETI | [signature] |
| 9 | ISMET RIFATI | [signature] |
| 10 | Mehdi Sejdiu | [signature] |
| 11 | GRAHIT RAMADANI | [signature] |
| 12 | Avni Isufi | [signature] |
| 13 | GANI JASHARI | [signature] |
| 14 | Sami Sadiku | [signature] |
| 15 | Ibrahim Shabani | [signature] |
| 16 | Salih Sadiku | S Sodiu |
| 17 | Musa Shabani | [signature] |

# REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
# REPUBLIC OF KOSOVO

## KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Vendi:
Date: 15.06.2023

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Nenshkrimi |
|---|---|---|
| 1 8 | SALI SADRIU | |
| 2 | LABINOT ABEDIN | |
| 3 | | |
| 4 | | |
| 5 | | |
| 6 | | |
| 7 | | |
| 8 | | |
| 9 | | |
| 10 | | |
| 11 | | |
| 12 | | |
| 13 | | |
| 14 | | |
| 15 | | |
| 16 | | |
| | | |